



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS LEPOSAVIQ

---

Numri i lëndës: 2022:211407

Datë: 22.08.2024

Numri i dokumentit: 06075904

P.nr.143/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË- Dega Lepasaviq- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Qëndresa Tahiri Islami, me bashkëpunëtoresh profesionale, Edita Koliqi, në lëndën penale ndaj të pandehurit: M.D, për shkak të veprës penale: Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të Kodit (Nr.06/L-074) Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.2058/22, të datës 26.10.2022, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 13.08.2024, në mungesë të Prokurorit të Shtetit Ajtene Zoni dhe të pandehurit M.D, në po të njëjtën ditë shpalli publikisht, ndërsa me datë 22.08.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

M.D, nga i ati R..., e ëma M..., e vajzërisë K..., i lindur me datë ..., në fshatin G..., R... – S..., ku edhe e ka vendbanimin, me profesion bujk, me numër personal ..., serb, shtetas i Serbisë.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Me datë 11.10.2022, rreth orës 05:30, në fshatin Koshutica – Lepasaviq, i pandehuri M..., me dashje, duke qene i vetëdijshëm se po kalon kufirin apo vijën kufitare të Republikës së Kosovës jashtë vendkalimeve të autorizuara zyrtare, në mënyrë ilegale ka bart mallra nga Republika e Serbisë përmes fshatit Koshutic me automjetin e tij ..., me targa të regjistrimit ..., në territorin e Republikës së Kosovës, me ç’rast dt.11.10.2022, rreth orën 05:30, është ndaluar nga ana e

policisë në fshatin Koshutic, Komuna Leposaviq, i cili gjendet afër vijës kufitare Kosovë – Serbi nga ana e pjesëtarëve të policisë së Kosovës të stacionit policor për mbikëqyrje të kufirit në Leposaviq, ka bart mallra dhe atë: kore për pite 175 copë, kajmak 05,5 kg gjithsej 9 kg, djathë 40 kg, kajmak 9 kg, djathë 20 kg, duke ju shmang doganës në shumë prej 85 euro.

-Me këtë ka kryer veprën penale: Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 43, 69, 70 si dhe 311 par.1 të KPRK-ës, dhe nenit 358, 364, 449, 269, 270 të KPP-së, i:

## S H Q I P T O N

- I. Dënim me gjobë në shumën prej 300 € (treqind euro), të cilin dënim - gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par.3, të KPRK - së, ashtu që dënimet me gjobë do të ia në dënim me burgim, duke llogaritur për çdo 20 € (njëzetë euro) gjobë të papaguar, me një (1) ditë burgim.
- II. Në mbështetje të nenit 311 paragrafi 6 dhe 7 të KPRK-së, e lidhur me nenin 269 dhe 270 të KPP-së, URDHËROHET KONFISKIMI i përhershëm i sendeve si në vijim:
  - Koret për pite 175 copë; kajmak 0.5 kg, gjithsej 9 kg; djathë 10% yndyrë, gjithsej 40 kg; kajmak 0.25, gjithsej 9 kg; djathë 0.5 kg, gjithsej 20 kg; si dhe Automjetin - Opel Astra me targa KV-091-JH.
- III. Urdhërohet Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar që sendet e konfiskuara sipas pikës II të këtij Aktgjykimi, t'i administroj sipas procedurave ligjore, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- IV. Obligohet i pandehuri, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzet euro), po ashtu edhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20€ (njëzet euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

V. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

## ARSYETIM

### Aktakuza

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.2058/22, të datës 26.10.2022, ndaj të pandehurit M.D, për shkak të veprës penale: Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

### Rrjedha e procedurës

Gjykata, me datë 13.08.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në praninë e palëve, Prokurorit të Shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Ajtene Zoni dhe të pandehurit M.D.

I pandehuri, gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, pas njoftimit nga gjykata me të drejtat e tij në këtë fazë të procedurës penale dhe leximit të aktakuzës, ka pranuar fajësinë në tërësi për veprën penale sipas aktit akuzues dhe deklaruar se ka qenë duke shtuar ne doganë, me profesion është bujk dhe vlera e mallit ka qenë shumë e vogël, e që atë mall ka dashur të ia dërgoj një personi në Leshak.

Gjykata ka marrë mendimin e Prokurorit të Shtetit mbi pranimin e fajësisë të deklaruar nga i pandehuri.

Prokurori i Shtetit Ajtene Zoni, propozoi Gjykatës që të miratoj pranimin e fajësisë, pasi është dhënë në mënyrë vullnetare, konform dispozitave të nenit 242 të KPP-së dhe ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Nga gjykata ka kërkuar që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe t'i shqiptohet një sanksion penal me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit, duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

### Gjetjet e Gjykatës

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilin e ka deklaruar i pandehuri M.D, në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e pranimit të fajësisë për të pandehurin. Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri mbështetet në

tërësi në provat që përmban kjo akuzë, siç janë: Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2022-YNC-064 i datës 11.10.2022; Raporti i oficerit dhe Raporti i policit me numër të rastit 2022-YNC-064 i datës 11.10.2022; Procesverbaet mbi intervistimin e të pandehurit; Foto albumi nga shkresat e lëndës ku vërehet edhe malli i kontrbanduar se bashku me veturën ... me të cilën është bartur malli; Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i datës 11.10.2022; Mendimi për përcaktimin e vlerës së mallit, nga Sektori i Vlerës – Dogana e Kosovës, e datës 12.10.2022; Raporti mbi rastin e përpiluar nga Sektori Antikontrabandë – Dogana e Kosovës, e datës 12.10.2022; si dhe shkresat e tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse dhe formojnë në tërësi elementet inkriminuese, e që në bazë të tyre dhe pranimi të fajësisë nga i pandehuri, përtej çdo dyshimi vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale: Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata gjen se pranimi i fajësisë është bërë nga i pandehuri në mënyrë vullnetare, pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë. Gjykata ia kishte tërheq vërejtjen të pandehurit se pas pranimi të fajësisë nuk mundet të shfrytëzojnë të drejtën në ankesë, lidhur me bazën për gjendjen faktike, i njëjti është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humb mundësinë e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësinë për paraqitjen e provave tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është një rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë. Gjykata gjithashtu ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as ndonjë gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë nga i pandehurit dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i pandehuri M.D është i përgjegjshëm dhe përgjegjës për veprën penale për të cilën akuzohet: Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Gjykata, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin M.D, ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-ës, e si rrethanë rënduese, gjykata ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale, dashjen e tij, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial të tij në këtë veprën penale, si dhe faktin se veprat e tilla penale janë gjithnjë e në rritje në shoqërinë tonë, rrethana të tjera rënduese nuk ka gjetur.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese, ka marrë për bazë faktin se i pandehuri ka treguar sjellje të mira, ka bashkëpunuar plotësisht me organet e rendit dhe drejtësisë që nga fillimi i procedurës kundër tij, duke kontribuar kështu në zbardhjen e shpejtë dhe të plotë të këtij rasti, keqardhjen e shprehur para Gjykatës për rastin e ndodhur. Ndërsa, si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurin është vlerësuar pranimi i fajësisë në tërësi për veprën penale që në hapje të shqyrtimit fillestar të çështjes.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, Gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me gjobë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 par.1 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata, thekson se për të pandehurin me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të pandehurin është i përballueshëm për kushtet ekonomike të tij.

### Konfiskimi

Gjykata ka vendosur si në pikën dy (II) të dispozitivit të këtij Aktgjykimi dhe ka urdhëruar konfiskimin e mallit dhe automjetit. Kjo duke u bazuar në nenin 311 paragrafi 6 dhe 7 të KPRK-së, të cilat dispozita përcaktojnë se: “6. Mallrat nga paragrafi 1., 2. ose 3 i këtij neni konfiskohen. Nëse mallrat nuk mund të gjinden ose për ndonjë arsye tjetër nuk mund të konfiskohen, paguhet ekuivalenti i shumës së mallrave. 7. Mjetet e transportit apo mjetet për bartjen e mallrave të cilat janë përdorur për transportimin e mallrave nga paragrafi 1.,2. ose 3 i këtij neni mund të konfiskohen.”. Gjithashtu, sipas dispozitës së nenit 269 paragrafi 1 të KPP-së, Gjykata urdhëron konfiskimin e të gjitha pasurive të specifikuar të përcaktuara në aktakuzë, ndërsa sipas nenit 270 paragrafi 1 të KPP-së, përcaktohet se para se Gjykata të vendos për konfiskim, prokurori i shtetit e provon se pasuria ishte mjet i veprës penale për të cilën i pandehuri është dënuar. Nga provat që gjenden në lëndë, nuk ishte kontestuese se mallrat e kontrabanduara, i pandehuri kishte tentuar që t'i bartë me këtë automjet, andaj edhe është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimi, në anën tjetër, këto mallra kanë qenë të propozuara në aktakuzë që të bëhet konfiskimi i përhershëm i tyre.

Në këtë kontekst, edhe dispozita e nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.38 pika 1.38.1, ka definuar se çka nënkuptojmë me mjet të veprës penale dhe kjo dispozitë përcakton se: “1.38.1. Pasuritë e përdorura për kryerjen e ndonjë veprimi në drejtim të veprës penale, përfshirë pasurinë e përdorur për të udhëtuar në apo nga vendi në të cilin është kryer ndonjë element i veprës penale, pavarësisht nëse mjetet e transportit janë përshtatur për të lehtësuar kryerjen e veprës penale ose jo;”.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e procedurës dhe ato për paushall gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 358, 364, 449, 269, 270 të KPP-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega Leposaviq  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal  
P.nr.143/2022, datë 22.08.2024

Bashkëpuntorja profesionale  
Edita Koliqi

Gjyqtarja e vetme gjykuese  
Qëndresa Tahiri Islami

KËSHILË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit me shkrim. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.